




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E GJILANIT
MUNICIPAL GJILAN - OPŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYESI



DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

DEPARTMENT OF ECONOMY DEVELOPMENT – UPRAVA ZA EKONOMSKI RAZVOJ - İKTİSADİ KALKINMA MÜDÜRLÜĞÜ

RAPORT

Janar - Mars 2016

Janar – Mars 2016

RAPORT

Prill, 2016

Agim Zuzaku, Drejtor
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

Raporti tremujor i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik (Janar – Mars 2016)

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik gjatë muajit janar – mars 2016 ka vazhduar me aktivitete të cilat kanë ndikuar në ngritjen e nivelit të zhvillimit ekonomik lokal në komunë, e gjitha duke përkrahur biznese të vogla e të mesme që të aplikojnë në thirrjet për grante që shpresojmë se do të rezultojnë sukses.

Gjilani tashmë është identifikuar si mbështetës i fuqishëm i bizneseve të vogla dhe të mesme, duke qenë emërues i përbashkët për zhvillim ekonomik lokal duke mbështetur afro 200 biznese për tre muaj të këtij viti.

- Gjatë kësaj kohe është punuar ngushtë me Asociacionin e Agjencive për Zhvillim Rajonal (ARDA) e cila gjatë muajit janar ka lansuar Skemën e Granteve për Zhvillimin e Sektorit Privat të, program i financuar nga BE, e cila ka për synim t'i ofrojë mbështetje ndërmarrjeve ekonomike të qëndrueshme dhe krijimit e vendeve të reja të punës. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik në bashkëpunim me Agjencinë Rajonale Lindje ka informuar komunitetin e biznesit dhe ka organizuar takim në sallën e Kuvendit me datë 21 janar ku është prezantuar thirrja e cila ka qenë e hapur deri më 15 mars. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik – Zyra për promovimin e bizneseve ka ofruar në vazhdimësi udhëzime për komunitetin e biznesit, thirrjeje ka qenë e ndarë lotet, ndërsa përqindja e financimit nga vetë aplikantët ishte nga 10% deri në 40%.

a) Loti 1 – Projekte të reja biznesi (ndërmarrje të reja fillestare)

Shuma për projekt nga 2,000 € deri në 5,000 €

b) Loti 2 – Ndërmarrjet ekzistuese por fillestare (ndërmarrje me më pak se 2 vjet)

Shuma për projekt nga 5,000 € deri në 10,000 €

c) Loti 3 – NVM-të (ndërmarrje ekzistuese të vogla, mbi 2 vjet)

Shuma për projekt ndërmjet 10,000 € - 20,000 €

Bazuar në të dhënat që posedon Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik në këtë thirrje kanë aplikuar nga Regjioni Lindje 297 aplikues të cilët i kanë dorëzuar aplikacionet në zyrën e RDA-së në Gjilan prej tyre 117 vetën nga Komuna e Gjilanit, përjashtimisht aplikuesit e kanë pas të drejtë të aplikojnë edhe përmes postes e gjitha bazuar në të dhënat që kemi nga regjioni lindje kemi afërsisht 450 aplikues, ndërsa llogaritjet që nga Komuna e Gjilanit afërsisht kemi 190 aplikacione.

- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik ka filluar edhe implementimin e programit të Help – Hilfe zur Selbsthilfe E.V, projekti financohet nga Qeveria Gjermane, Qeveria e Kosovës, Komuna e Gjilanit. Projekti ofron "Mbështetje stabilitetit socio-ekonomik përmes fuqizimit të mikro-bizneseve në Kosovë" dhe do të realizohet gjatë periudhës Maj 2015 deri Dhjetor 2016.

Gjatë muajit shkurt (24 shkurt) është mbajtur sesioni informativë me komunitetin e biznesit ndërsa me datë 31 mars është mbyllur thirrja për aplikim në këtë projekt

Nëpërmjet këtij projekti, planifikohet të shpërndahen rreth 40 grante, (për Komunën e Gjilanit) duke ofruar pajisje në mënyrë që përfituesit të mund të fillojnë apo rrisin biznesin e tyre. Vlera totale mesatare e një granti, për një përfitues, do të jetë 2,000.00 €, shumë kjo e cila përfshinë edhe investimin nga përfituesit prej 15%. Krahas pajisjeve, përfituesve do t'u ofrohen edhe trajnime profesionale dhe mbështetje teknike pasi të kenë pranuar pajisjet.

- Po ashtu dy programet e Komisionit Evropian janë në fazën e përfundimit – fjala është për programet:
 - Programi BE – BNK Bashkëpunimi Ndërkufitarë Komuna e Gjilanit (KS) & Komuna e Çairit (MK) e cila implementohet edhe në bashkëpunim me dy organizata jo qeveritare Organizata AgorEko (Gjilan) dhe Initiative for European Perspective (Çairë), emri i projektit: Valorizimi i tregtisë tradicionale dhe potenciali socio - ekonomik), ky program ka shpërndarë 28 grante në vlerë prej 2,000€ për aplikuesit ku shumica e tyre kanë qen nga sektor i zejtarëve.
 - Programi BE – EURED, emri i programit: Zhvillimi i Agrobizneseve në Regjionin e Gjilanit, që po realizohet nga Organizata CARE dhe ATRC në kuadër të projektit të përbashkët që zbatohet në partneritet me Komunën e Gjilanit 'Përkrahja e agrobizneseve në Regjionin e Gjilanit' me datë 6 prill do të organizohet takime Biznese me Biznese (B2B) dhe Biznese me Konsumatorë (B2C). Ky aktivitet ka paraparë të bëjë lidhjen e dy e më shumë bizneseve nga Regjioni i Gjilanit me profile të ngjashme me qëllim të arritjes së bashkëpunimit në mes tyre.
- Programi KYDP (Kosovo Youth Development Projekct) - Projekti për Zhvillimin Rinisë në Kosovë i cili ofron trajnim falas për ndërmarrësit e rinj. Projekti është financuar nga Banka Botërore dhe ka për qëllim përkrahjen e të rinjve në biznes nëpërmes trajnimeve dhe granteve. Projekti financohet nga Banka Botërore dhe implementohet nga organizata "Qendra Rinore" Gjilan, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka siguruar tani më shtatë zyre brenda hapësirës së Inkubatorit të Biznesit, programi po realizohet me

suksese, ndërmarrësit e rinjë tani po aftësohen ne aktivitet e tyre për të krijuar një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik - është duke bashkëpunuar ngushtë edhe me Organizatën Qeveritare Gjermane Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit – GIZ, në Hartimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave, tani më ky dokument është draftuar dhe është prezantuar në Komitetin e Shënimeve Publike, po ashtu GIZ po ndihmon Drejtorin e Shërbimeve Publike në nxjerrjen e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave dokument ky i cili i hapë rrugë implementimit të Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave.

GIZ – do të mbështesë Komunën e Gjilanit edhe gjatë vitit 2016 në realizmin e këtyre objektivave të përbashkëta:

- a) Përfundimin e fazës së parë të Pilot Projekti “Gjilani Riciklon” ku përfshihet trajnimi i mbeturinave në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të qytetit
- b) Fillimin e fazës së dytë të Pilot Projekti “Gjilani Riciklon” ” ku përfshihet trajnimi i mbeturinave në të gjitha shkollat fillore në fshatra.

- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik - është duke koordinuar aktivitet edhe me Organizatën Qeveritare Gjermane Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit – GIZ, e cila po implementon projektin “Promovimi dhe konkurrentshmëri se sektorit privat në zonat rurale - COSiRA” të financuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik -BMZ.

Projekti i GIZ COSiRA "Konkurrueshmëria e sektorit privat në zonat rurale ", përfshin institucionet private dhe publike në nivel lokal në identifikimin e avantazheve krahasuese rajonale, në këtë projekt është i përfshirë regjioni Anamoravës dhe AnaDrini.

- KfW (Bankën Gjermane për Zhvillim) – është e fokusuar në projektet të cilat kanë të bëjnë me Eficiencën e Energjisë kryesisht në ndërtesa publike.

Hapat e ardhshëm janë angazhimi konsulencës për implementimin e projektit që përfshin analizimin e projekteve të identifikuar si dhe identifikimin e projekteve shtesë që do të përfshihen në program (këtu do të shqyrtohen objektet e identifikuar nga komunat), trajnimin e stafit të komunave për operimin dhe mirëmbajtjen e objekteve dhe monitorimin e implementimit të punëve ndërtimore nëpër objekte.

Komuna e Gjilanit – Drejtoria për Zhvillim Ekonomik (Zyra për EE) në bashkëpunim me Drejtorin e Arsimit kanë identifikuar projektet e EE.

KfW ka kërkuar angazhim aktiv të komunave në mënyrë që të adresohen as më mirë kërkesat /nevojat e komunave dhe ka kërkuar që secila komunë të emëroj një person përgjegjës për këtë projekt, i cili/e cila do të jetë pik kontakti për ne në këtë proces.

- Qendra për Regjistrim të Bizneseve (QRB) në Gjiilan gjatë periudhës janar – mars 2016 ka kryer aktivitet e saja sa i përket kërkesave të qytetareve për regjistrim të bizneseve dhe komunitetit të biznesit për nderim dhe shtim të aktiviteteve biznesore apo edhe shuarje të biznesit.

Bazuar në të dhënat nga Qendra për Regjistrim të Bizneseve (QRB)

Emërtimet	Janar	Shkurt	Mars
Biznese Prodhuese	7	7	7
Biznese Tregtare	17	18	4
Biznese Shërbyese	23	30	30
Biznese Ndërtimore	1	3	8
Gjithsej:	48	58	49
Pronar femra	8	13	4
Pronar meshkuj	40	45	45
Punëtorë në Biznes	88	93	98

Qendra për Regjistrim të Bizneseve (QRB) në Gjiilan po kryen edhe këto aktivitete shuarjen e biznesit, informata, Ndryshime në biznes (Certifikatë të biznesit), Certifikata të reja (ndërrime nga certifikata e UNMIK-ut), Vërtetime për mos posedim të biznesit si dhe aktivitet tjera në përputhje me Ligjet në fuqi dhe Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë.

- Sektori i Inspeksionit gjatë periudhës janar – mars ka inspektuar bizneset që nuk janë të regjistruara, po ashtu ka njoftuar komunitetin e biznesit për rregulloret komunale (orari i punës) dhe (taksa komunale) gjatë kësaj periudhe ka kryer këto aktivitete në teren :

Procese të hartuara në teren: 139

Pranime teknike të lokaleve afariste: 35

Refuzim i pranimeve teknike: 1

Lokale të mbyllura : 1

Gjobat mandatore: 1

Përgjigjeje në kërkesa: 5

Të hyra nga pranimet teknike: 2810

Të hyra nga gjobat mandatore: 500 €

- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik – po implementon suksesshëm LIGJIN Nr. 05/L -043 - PËR FALJEN E BORXHEVE PUBLIKE, po e themi suksesshëm nga se Drejtoria për Zhvillim Ekonomik përmes programit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (projektin “Praktikë në Punë” (PNP) që implementohet nga Qendra Regjionale të Punësimit pjesë e këtij programi kemi një praktikante (Saranda Rashiti) kemi mungesë të stafit.

Pos aspektit të Ligjit për faljen e borxheve, në cilësinë e praktikantes znj. Rashiti po mbanë protokollin elektronik dhe të brendshëm duke mbyllur lëndë në protokollin elektronik.

Ne po paraqesim në mënyrë tabelare një pjesë të punës të programit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (projektin “Praktikë në Punë” e cila është menaxhuar nga praktikantja e lartpërmendur e cila në mënyrë aktive po e ndihmon dhe udhëzon komunitetin e biznesit rethë Ligjit për falejn e Borxheve.

Tabela:

Të dhënat € për vitet 2015-2016		
Pjesa e pagur 2009-2014	Borxhe e falura 2009-2015	Të falura automatikisht nën 100
29,318.28 €	36,844.17 €	39,386.89 €
Totali i borxhit të falur është		
36,844.17	39,386.89	76,231.06

Gjatë kësaj periudhe (5) pesë biznese kanë bërë marrëveshje për pagesën e borxhit me këste e gjitha në përputhje me Ligjin për faljen e borxheve publike nr. 05/L -043, ndërsa Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka inkasuar në total: 29,318.28 €.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik bënë të ditur se janë mjaft pozitive aktivitetet që po zhvillon për të implementuar Ligjin për faljen e borxheve publike.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik u bënë thirrje qytetarëve të Komunës së Gjilanit që të shfrytëzojnë mundësinë që ju jep Ligji për faljen e borxheve publike dhe të fillojnë sa më shpejtë në kryerjen e obligimeve dhe fillimin e proceduarave për faljen e borxheve.

Është një mundësi e mirë që qytetarët ta shfrytëzojnë këtë të drejtë para datës 2 shtator 2016, sepse pas datës 2 shtator 2016 Ligji do të shfuqizohet dhe qytetarët nuk mund ta shfrytëzojnë këtë mundës.

Qëllimi i këtij ligji është falja e borxheve publike ndaj Institucioneve Shtetërore dhe Ndërmarrjeve Publike, si dhe përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për faljen e këtyre borxheve, që personat fizikë dhe juridikë kanë për periudhën deri më 31 dhjetor 2008. Ne po paraqesim raportin mbi faljen e borxheve.

- Zyra për financa - po përcjell dhe po koordinohet në aktivitet të përditshme dhe me Drejtorin e Buxhetit dhe Financave ku po përcillen projektet kapitale, ato të mallrave dhe shërbimeve si dhe komunalit.

Është punuar në programin për nxjerrjen e vendimeve për ngarkesa me takes komunale për vitin 2016, si dhe janë përgatitur bllok procesverbale për hartimin e procesverbaleve në teren nga analistët e bizneseve, për bizneset të cilat do të ngarkohen me takës komunale sipas rregullores së vitit 2016.

VENDIMET E TAKËSËS KOMUNALE: deri më tani nuk kam filluar me lëshimin e vendimeve për ngarkesa me Taksa Komunale, analistët e bizneseve i kanë hartuar dhe lëshuar gjithsej 110 procesverbale, për bizneset të cilat do të ngarkohen me takes komunale sipas rregullores së vitit 2016.

- **TË HYRAT E PLANIFIKUARA:** Për vitin 2016
 - Nga taksa komunale ndaj bizneseve : 150,000.00 €
- **TË HYRAT E REALIZUARA:** prej 01.01.2016 deri më 30.03.2016
 - Nga taksa komunale ndaj bizneseve 20,910.52 € apo 55.76 % nga planifikimi për këtë periudhë,
 - Borxhi i përgjithshëm i mbetur (saldo) nga vitet paraprake është 1,764,460.71 €.

Kam proceduar 41 lëndë deri në pagesë për Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik dhe atë:

- ✓ për investime kapitale 8 lëndë në vlerë – 42556.02 € ;
- ✓ për mallra dhe shërbime 21 lëndë në vlerë – 10,562.26 € ;
- ✓ për komunalit 8 lëndë në vlerë – 665.34 €
- ✓ për Komisionin e aksionarëve 9 lëndë në vlerë – 2600.00 €

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka kryer edhe këto aktivitet të cilat kanë ndikuar në përmirësimin e bashkëpunimit me arteret të cilët ndikojnë në Zhvillimin Ekonomik Lokal:

- Partneriteti Publiko Privat: Projektit “Kompleksi i shkollave të mesme” tani është në fazën fillimit të ekzekutimit të projektit nga kompania “Hoteli Kristal” sh.p.k & N.N. “Danushi-Com” - Gjilan .

Tani jemi në fazën për përgatitjen e raportit të fizibilitetit për projektet:

- a) Palestra sportive “Bashkim Selishta” dhe
- b) Objektet përcjellëse (stalla e lopëve, sera, plantacioni, depoja ftohëse për pemë dhe perime) të shkollës së mesme bujqësore “Arbëria..

- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik në sajë të bashkëpunimit ka fuqizuar marrëdhëniet me Ministrinë e Financave të Kosovës dhe Ministrinë e Financave të Austrisë, për realizimin e programin (Soft Loan Project) i cili program i dedikohet projekteve madhore që përfshin infrastrukturën publike me fokus të veçanët rrjete të kanalizimit dhe trajtim të ujërave të zeza.
- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik gjatë muajit dhjetor 2015 në koordinim me Zyrën e kryetarit ka përgatitur projektet dhe ka aplikuar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal në Programin Komunal për Zhvillim të Infrastrukturës i cili program bashkë-financohet nga Komisionin Evropian (KE) me këto projekte:
 - a) Rekonstruimi i rrugës “Adem Jashari” dhe “Zija Shemsiu” Gjilan,
 - b) Ndërtimi i infrastrukturës të zonës së përbashkët ekonomike (Gjilan dhe Novobërdë)
 - c) Salla sportive - shkolla fillore dhe e mesme “Vuk Karaxhiqi” fshatin Shillovë
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik – ka pas një bashkëpunim të mirë dhe ka koordinuar aktivitete e saja edhe me Komitetin për Zhvillim Ekonomik, si dhe partitë politike ku të gjitha kërkesat e adresuara nga partitë politike kanë marrë përgjigjen në kohë të caktuar.
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik ka bashkëpunuar edhe me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) gjatë kësaj kohe kemi bërë identifikimin dhe evidentimin e pronave – tokave të Ndërmarrjeve Shoqërore të cilat menaxhohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit të cilat prona janë në territorin e komunës së Gjilanit dhe janë me interes të përgjithshëm publikë (lokacioni i “Varrezave të Reja” të qytetit)
- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik – po bashkëpunon ngushtë edhe me shoqata si GAP, KDI, MDA e cila po bënë një Hulumtim mbi Industrinë e Duhanit (Perspektiva e industrisë së duhanit në Komunën e Gjilanit (periudhat kohore - para lufte dhe pas lufte), po ashtu UBT ku kem prezantuar të arriturat e Komunës së Gjilanit në konferencën: Austrian Kosovo Smart Infrastructure – Day 2016)
- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik – në bashkëpunim me zyrën e kryetarit dhe Agjencinë për Zhvillim Rajonal (ARDA) planifikojnë organizimin e një konference për investitor ku do të promovonin resurset lokale.
- Po ashtu kemi pas takim edhe me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë – Departamentin Turizmit me temën kapacitete humane në Regionin e Gjilanit, pasi turizmi rural shihet si një ardhur e mirë e zhvillimit ekonomik lokal.

PLANIFIKIMI PËR TË ARDHMEN:

- THEMELIMI I NDËRMARRJES SË RE LOKALE “TREGU”
- VLERËSIMI I APLIKACIONEVE DHE PËRZGJEDHJA E PËRFITUESVE PROGRAMI HELP
- VLERËSIMI I APLIKACIONEVE DHE PËRZGJEDHJA E PËRFITUESVE PROGRAMI ARDA
- IMPLEMENTIMI I REKOMANDIVE TË NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
- FORMIMI I KËSHILLIN KONSULTATIV LOKAL

Përgatitur nga:
Fadil OSMANI, Zyrtar për Promovimin e Investimeve
mob: +377 45 218 100
E-mail: fadilosmani02@yahoo.com